



Opština Klokot/Komuna e Klokot

Në bazë të nenit 58. Paragrafi (a,b) ; Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr: 03/L-040; nenit 17. Nga Ligji nr: 03/L-048 dhe nenit 7. Dhe nenit 12. Rregullorja MF – br.04/2017 mbi kriteret ,standardet dhe procedurat e financimit public të OJQ-ve si dhe nenit 32. Paragrafi (a,b) Statutit të Komunës së Klokotit 10815/2 të datës : 31.07.2018,kryetari I komunës së Klokotit z.Bozhidar Dejanoviq sjell këtë:

VENDIM

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projekte/programme të organizatave jo-qeveritare në fushën e,„**MENAXHIMI I SITUATATËS LIDHJE ME PANDEMINË KORONAVIRUS COVID-19 NË FUSHAT E SHËNDETËSISË,ARSIMIT,BUJQËSISË DHE NË TË GJITHA SEGMENTET E JETËS SHOQËRORE,,**

I

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores MF-Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga **Buxheti i komunës për vitin 2020, kodi ekonomik 10/660/16036/00098/200/0111,Subvencionet dhe transferet në kuadër të programit 160 nënprogrami 16036.**

II

1. Mjetet e përmendura në nenin do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi përfshinë:

1. Teksti i thirrjes publike
2. Udhëzimet për aplikantët
3. Formularët e aplikimit
4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
5. Format për raportimin e zbatimit të projektit

2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:

1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
3. Forma e deklaramit të mungesës së fondeve të dyfishta
4. Deklaratat e Partneritetit (nëse është e aplikueshme)
5. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike.
6. Deklarata për Aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet).

3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:

1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit

IV.

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare në të dyja gjuhët zyrtare:

Linku në gjuhën Serbe: <https://kk.rks-gov.net/kllokot/sr/category/javni-poziv-za-nvo/>

Linku në gjuhën Shqipe: <https://kk.rks-gov.net/kllokot/category/ftese-publike-per-ojq/>

V.

1. Në përputhje me Rregulloren MF-Nr.-04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren Nr: 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të OJQ-ve.

VI.

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, Kryetari I komunës merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/ programeve të OJQ-ve.

2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.

3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është njësia/departamenti :

- a) Departamenti I Administratës ,personelit dhe Sherbimeve Publike,
- b) Departamenti për Ekonomi,Financa dhe Buxhet.

VII.

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit

Data: 28.10.2020

Kryetari i komunës Klllokot



/ Božidar Dejanović/